TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. I/22
Dt. 15.03.2023
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

trainkos
Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2022

Vendimi: Nr. *I/22*

Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2022 në mbledhjen Nr. 10 të mbajtur më datë 15.03.2023

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	**Gelor SHALA** **Kryeshef Ekzekutiv**	**Nol DEDAJ** **Kryesuesi i BD**
Nënshkrimi:		Për
Data:	**15.02.2023**	**15.03.2023**

trainkos

Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2022



Fushë Kosovë,
Shkurt 2023

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	4
II.	RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	5
II. 1.	Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	6
II. 2.	Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenten	9
II. 3.	Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë	10
II. 4.	Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh. A.	11
III.	FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	12
III. 1	Ngjarjet kryesore të vitit	13
IV.	PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE	14
IV. 1.	Transporti i Mallrave	14
IV. 2.	Transporti i Udhëtarëve	18
IV. 3.	Zyra e Mirëmbajtjës së Mjeteve Lëvizëse	21
V.	PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET	24
V. 1.	Gjendja financiare	24
V.1.1.	Të hyrat	24
V.1.2.	Shpenzimet	25
V.1.3.	Të hyrat dhe Shpenzimet Operative	26
V. 2.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas Bankës (31.12.2022)	29
V. 3.	Transaksionet e realizuara	29
V. 4.	Bilanci i gjendjes	30
VI.	PROJEKTET KAPITALE	31
VII.	DEPARTAMENTI I ZHVILLIMI I BIZNESIT	32
VII.1.	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit	32
VII.2.	Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH-në dhe Institucionet tjera relevante	36
VII.3.	Aktivitetet e Marketingut	39
VII.4.	Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore dhe Sekretariatin për Zbatimin e Traktatit për Transport	41
VII.5.	Shqyrtimi i mundësive për kryerjen e veprimterisë – Shpedicion për klientët e TRAINKOSIT	41
VII.6.	Sfidat kryesore gjatë vitit 2022 dhe veprimet për të ardhmen	41
VIII.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH. A.	43
IX.	ZYRA LIGJORE	45
IX.1.	Kontestet gjygjësore	45
IX. 2.	Rreziqet nga kontestet gjygjësore për vitin 2022	46
X.	PËRFUNDIM	47

I. ANEKS RAPORTI

Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet

Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022

Raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve

I. HYRJE

Gjatë gjithë vitit 2022, kompania kishte një ecuri progresive drejt realizimit të planit operativ dhe financiar. Megjithatë, ndërmarrja gjatë këtij viti është ballafaquar me një sfidë shumë të madhe siç është pandemia COVID 19, kriza energjetike që kaploi jo vetëm vendin tonë dhe vonesat që po ndodhin në realizimin e projektit për Modernizimin e linjës së 10-të hekurudhore, sesioni Jug (Fushë Kosovë – Hani i Elezit). Mirëpo falë angazhimit të palodhshëm të tërë ekipit të HK - Trainkos Sh. A. është arritur që ndërmarrja të ruaj likuiditetin e saj.

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2022. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj.

Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2022 i HK - Trainkos Sh.A. ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 dhe Raporti i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Në fillim të muajit gusht 2022 është emëruar Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A. Që nga kjo periudhë Bordi është angazhuar me përkushtim të lartë që Ndërmarrja të ketë kontinuitet të punëve në arritjen e rezultateve në raport me objektivat e planifikuara. Mirëpo, përkundër angazhimit dhe përkushtimit tonë, gjendja e Ndërmarrjes nuk është arritur që të përmirësohet. Problemet e trashëguara ndër vite sa janë rritur e bartur në këtë periudhë dhe zgjidhja e tyre do të jetë tejet sfiduese për të gjithë ne.

Edhe pse nuk kemi arritur rezultate të dëshirueshme operative e financiare, përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive tjera ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit. Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 06/L-016), Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.A, në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për Ndërmarrjen si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë përpjekje e vazhdueshme për një qeverisje korporative sipas standardeve më të larta.

Në vijim, në këtë raport-vështrim do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2022.

II. 1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes gjatë vitit 2022 kanë qenë në drejtim të realizimit të objektivave të planifikuara për këtë vit si dhe në drejtim të tejkalimit të pengesave dhe vështirësive tjera të ndërmarrjes.

Ndër sfidat e para, me të cilat u ballafaquam qysh në fillim të punës sonë, ishte në përgjithësi gjendja e rëndë financiare e Ndërmarrjes, e cila vazhdon edhe sot të jetë e tillë.

Ndikimi nga pandemia Covid-19, kriza ekonomike e ndikuar nga lufta në Ukrainë kishin ndikuar dukshëm në gjendjen e ndërmarrjes, e cila edhe ashtu kishte qenë e rëndë.

Ndërprerja e prodhimit/transportit nga klienti kryesor NewCo Ferronikeli, por edhe ndërprerjet e transportit hekurudhor nga punimet që janë duku u zhvilluar në rehabilitimin e Linjës së Dhjetë hekurudhore kanë paralizuar pothuajse në tërësi transportin ndërkombëtar të mallrave dhe të udhëtarëve.

Gjendja e mjeteve lëvizëse hekurudhore edhe pse të pakta në numër, ato gjithashtu nuk janë në gjendje të mirë dhe janë shumë të vjetruara. Pamundësia e ripërtëritjes së tyre për shkak të mungesës së fondeve e ka rënduar edhe më shumë gjendjen në përgjithësi.

Borxhet e akumuluara si në raport me partnerët ashtu edhe me institucionet tjera veç sa i shtohen listës së sfidave të Ndërmarrjes.

Për të gjitha problemet e theksuara, Bordi i Drejtorëve është angazhuar që të gjej zgjidhje dhe të dalë nga kjo situatë, por fatkeqësisht këto do të vazhdojnë edhe më tutje të jenë sfiduese për Ndërmarrjen.

Gjithashtu, aktivitetet dhe angazhimet tjera, gjatë gjithë punës tonë kanë qenë edhe në drejtime tjera, si në angazhimin në përmbushjen e rekomandimeve të auditorëve për të gjeturat nga auditimi i vitit paraprak dhe gjithashtu edhe në përgatitjen për hartimin e dokumenteve strategjike e politikave tjera, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh. A.

- **Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2022**

Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2022 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Mirëpo, edhe pse Ndërmarrja kishte bërë rishikimin e planifikimit për këtë vit, për arsyet që u theksuan, përsëri objektivat e planifikuara nuk janë arritur.

Në funksion të arritjes së objektivave dhe me qëllim të përmirësimit të gjendjes janë ndërmarrë masat në takime të shtuara me klientët dhe partnerët tanë.

Me Menaxherin e Infrastrukturës janë mbajtur takime e zhvilluar kontakte të shumta për të ndikuar që Linja e Hanit të Elezit të jetë në funksion edhe gjatë punimeve në këtë Linjë sipas një orari të përshtatshëm për qarkullimin e trenave. Po ashtu takime e kontakte janë mbajtur

edhe më KEK-un për të parë mundësitë e transportit të thëngjillit.

Janë zhvilluar edhe takime tjera me biznese e organizata ndërkombëtare që kanë shfaqur gatishmëri për investime në vendin tonë.

Hartimi dhe rishikimi i politikave të Ndërmarrjes ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022, disa prej tyre janë hartuar për herë të parë, të cilat definojnë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve.

Bashkëpunimi me institucionet vendore e ndërkombëtare gjithashtu ka qenë në fokus të angazhimit tonë dhe nuk kanë munguar përpjekjet tona në këtë drejtim.

- **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual**

Gjatë vitit 2022 Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. kanë pasur një rezultat jo të kënaqshëm operativ e financiar. Realizimi operativ e financiar ka shënuar ulje në krahasim me vitin paraprak, gjithashtu as objektivat e planifikuara për vitin 2022 nuk janë arritur plotësisht.

Realizimi operativ e financiar në transportin e udhëtarëve ka qenë më afër objektivave të planifikuara, ndërsa krahasuar me realizimin e vitit paraprak kemi pasur realizim më të mirë. Te transporti i mallrave realizimi operativ e financiar, ashtu si me planifikimin, ashtu edhe në krahasim me vitin e kaluar ka qenë në shkallë shumë më të ulët të realizimit.

- **Transporti i Mallrave**

Performanca operative në transportin e mallrave, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelare por edhe përshkruese të këtij raporti, është arritur në shkallën prej vetëm 7.12 % neto ton mallra të planifikuara për vitin 2022, apo 95.85 % më pak se sa vitin paraprak.

Gjithashtu, edhe performanca financiare nga transporti i mallrave është arritur në shkallën prej vetëm 12.56 % të planifikimit vjetor 2022, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi rënie në shkallën prej 93.5 %.

- **Transporti i Udhëtarëve**

Performanca operative në numrin e udhëtarëve është për 17.38 % më e lartë në krahasim me vitin paraprak si dhe për 10.38 % më shumë se sa planifikimi për vitin 2022.

Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave, përkatësisht të të hyrat nga kjo kategori kanë qenë 19.34 % më shumë krahasuar me vitin 2021, ndërsa krahasuar me planifikim për vitin 2022 të hyrat kanë qenë prej 12.7 % më pak.

- **Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes**

Një ndër sfidat kryesore për kompaninë Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse duke pasur parasysh numrin e vogël të këtyre mjeteve që kemi në dispozicion por edhe vjetërsinë e tyre të cilat përveç shpenzimeve të larta për mirëmbajtje kanë edhe shpenzime tjera operuese të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kostos se përgjithshme.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2022 janë shfrytëzuar në masë prej 44.5 % të totalit të tyre.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh. A.

Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet përpilimi dhe hartimi i politikave strategjike për zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve t'u japë shtytje për realizim.

Gjithashtu, vlen të theksohet se shërbimet e veçanta që ofrojmë kërkojnë edhe përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë përgatitja e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit nga institucione e organizata ndërkombëtare relevante.

- **Të priturat për vitin e ardhshëm**

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse apo edhe në blerjen e mjeteve të reja. Për ketë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e Aksionarit, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve apo formave tjera për investim shpresojmë se do t'ia dalim.

Për këtë qëllim, gjatë këtij viti do të angazhohemi në hartimin e një plani strategjik-investiv, duke u bazuar edhe në Strategjinë e Transportit Multimodal, në të cilin planifikohet që krahas me zhvillimet në infrastrukturën hekurudhore të bëhen edhe investimet në mjetet lëvizëse.

Sfidat me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm do të jenë ndikuese edhe në arritjen e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2023. Problemet e ndërprerjes së transportit për shkak të punimeve që janë duke u zhvilluar në Linjën e 10-të Hekurudhore, do të jenë çështja më sfiduese për zhvillimin e punës dhe të projekteve të Ndërmarrjes.

II. 2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Gjatë vitit 2022 ndërmarrja ka zhvilluar procedurat për projektet kapitale, përkatësisht procedurat për realizimin e tyre, mirëpo nuk është arritur që ato të realizohen në tërësi.

Përveç tjerash, një prej shkaqeve të mos realizimit të disa projekteve ka qenë nënshkrimi me vonesë i Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Financim (18.08.2022). Mjetet e planifikuara në këtë Marrëveshje për projektet kapitale kanë qenë në shumën prej 489,725.00 €, mirëpo ato janë shfrytëzuar në shkallën prej vetëm 44.5 %, janë realizuar vetëm një pjesë e projekteve.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. gjatë këtij viti kanë nënshkruar marrëveshje kredituese me Ministrinë e Financave (***Kredia e likuiditetit të urgjencës së infrastrukturës vitale)*** në shumën prej 364,963.00.

Ndërsa, sa i përket shpërndarjes së **dividentës**, Ndërmarrja nuk ka arritur atë nivel të realizimit (fitimit) për ta ndarë atë ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

II. 3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 03/92, të datës 10.08.2022, ka emëruar Bordin e ri të Drejtorëve të HK-Trainkos Sh. A, andaj të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë, në këtë pjesë të raportit, do të pasqyrohen edhe për Bordin e Drejtorëve që ka funksionuar deri më 10.08.2022.

Struktura e Bordit të Drejtorëve deri më datën 10.08.2022 ka qenë e përcaktuar në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/96, të datës 02.04.2019 për emërimin e Bordit të Drejtorëve, me përjashtim të njërit prej drejtorëve, i cili më datë 12.08.2021 ka dhënë dorëheqje nga Bordi.

Bazuar në vendimet e theksuara më sipër dhe në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur gjithsejtë shtatëmbëdhjetë (17) mbledhje të Bordit të Drejtorëve, nëntë (9) prej tyre janë mbajtur deri më datën 10.08.2022 dhe tetë (8) mbledhje tjera janë mbajtur pas kësaj date, duke llogaritur edhe Mbledhjen e Kuvendit Vjetor të Aksionarëve.

Në pjesën në vijim do të pasqyrohen të dhënat për strukturën dhe mbledhjet e Bordit të Drejtorëve për vitin 2022.

Të dhënat për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve nga data 01.01.2022 deri më 10.08.2022:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
1	Ramush Ahmetaj	Kryesues	9
2	Agim Preniqi	Anëtar	9
3	Ylber Shabani	Anëtar	4
4	Mustafa Mustafa	Anëtar	8
5	Ramiz Rrustaj	Anëtar	9
6	Gelor Shala	Kryeshef Ekzekutiv	9
7	Afrim Kuleta	Sekretar	9

Të dhënat për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve nga data 10.08.2022 deri më 31.12.2022:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
1	Nol Dedaj	Kryesues	8
2	Astrit Mehaj	Anëtar	7
3	Drita Kadriu-Berisha	Anëtar	8
4	Blerina Shamolli	Anëtar	8
5	Riza Spanca	Anëtar	8
6	Shaban Neziri	Anëtar	5
7	Gelor Shala	Kryeshef Ekzekutiv	8
8	Afrim Kuleta	Sekretar	8

II.4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK-TRAINKOS SH.A

Gjatë vitit 2022 Bordi nuk ka pasur të formuar komitete, ato planifikohen të formohen gjatë vitit 2023. Mirëpo, me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së Ndërmarrjes, punën e Bordit të Drejtorëve e ka ndihmuar Komisioni i Auditimit, i cili është formuar nga Aksionari. Kontributi i Komisionit të Auditimit ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit.

Gjatë vitit 2022, përkatësisht deri më 10.08.2022, përbërja e Komisionit të Auditimit ka qenë sipas Vendimit të ish-MZHE-së, Nr. 01/1038, të datës 06.05.2019, ndërsa pas datës 10.08.2022 përbërja e Komisionit të Auditimit ka qenë sipas Vendimit të ME-së Nr. 01/1909, të datës 15.08.2022.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim të dhënat për përbërjen e Komisionit, kohën e funksionimit dhe mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2022.

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur gjithsejtë katërmbëdhjetë (14) mbledhje të Komisionit të Auditimit, nëntë (9) prej tyre janë mbajtur deri më datën 10.08.2022 dhe pesë (5) mbledhje tjera janë mbajtur pas kësaj date.

Të dhënat për mbledhjet e Komisionit të Auditimit nga data 01.01.2022 deri më 10.08.2022:

Komiteti (koha e funksionimit)		Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMISIONI I AUDITIMIT 06.05.2019[1] – 10.08.2022	1	Ramiz Rrustaj	Kryesues	9
	2	Agim Preniqi	Anëtar	9

Të dhënat për mbledhjet e Komisionit të Auditimit nga data 10.08.2022 deri më 31.12.2022:

Komiteti (koha e funksionimit)		Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMISIONI I AUDITIMIT 15.08.2022 - aktiv	1	Riza Spanca	Kryesues	5
	2	Drita Kadriu-Berisha	Anëtar	5
	3	Astrit Mehaj	Anëtar	4

Në emër të Bordit të Drejtorëve të HK-Trainkos Sh.A.

Dr.sc. Nol DEDAJ – Kryesues

[1] Më 12.08.2021 njëri prej drejtorëve ka dhënë dorëheqje nga Bordi, respektivisht edhe nga Komisioni i Auditimit, dhe deri më 15.08.2022 Komisioni i Auditimit ka funksionuar me vetëm dy anëtarë.

III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK TRAINKOS Sh. A. vitin 2022 arriti që ta përmbyll me rezultate jo të kënaqëshme, duke marr për bazë ndikimin e shumë faktorëve të ndryshëm si: mosfunksionimi normal në transportin e mallrave për shkak të konkurencës jo lojale nga operatorë të transportit rrugorë të mallrave, qasja vetëm në një portë doganore-linjë ndërkombëtare, ndërprerja e plotë e linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit, konkretisht zbatimi i projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore.

Ndikimit të pandemisë dhe faktorëve që u thanë më lartë, ne si ndërrmarrje gjatë vitit 2022 kemi hasur në probleme të mëdha, sidomos në mos realizimi e planifikimeve të deklaruara nga ana e bashëpuntorëve (klientët) tanë, kemi pasur ndikim direkt në (mos) përmbushjen e parashikimeve sipas Planit të Biznesit, e sidomos me paraqitjen e krizës energjetike ku klienti/operatori ynë New Co Feronikeli ndërpreu punën.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimin e afateve ligjore të raportimit, ndërmarrja ka arritur që këto obligime ti përmbush me sukses. Trainkos Sh. A. me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme të operimit nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek aksionari mbi gjendjen dhe zhvillimet në kompani.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Vazhdojnë të mbetën sfidë, fondet e pamjaftueshme për investime kapitale në modernizimin dhe rritjen e flotës operuese, mjetet me të cilat operojmë janë të vjetra dhe si rrjedhojë krijojnë edhe shpenzime të mëdha.

Aktualisht transporti ndërkombëtar hekurudhor zhvillohet vetëm përmes Maqedonisë së Veriut, por për shkak të punimeve që janë duke u bërë në realizimin e projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore" edhe këtu kemi pasur pengesa të mëdha për shkak të vonesave të mëdha që janë duke ndodhur, kufiri në veri qëndron i mbyllur për arsye të ditura politike edhe pse në aspektin teknik linja hekurudhore është e operueshme, ky fakt ka hendikepuar në masë të madhe ndërmarrjen tonë në funksionimin normal në transportin e mallrave duke bërë që shumë klient potencial të orientojnë transportin duke zgjidhur alternativa tjera.

Gjithsesi, duke u bazuar në këto rrethana me investime të vazhdueshme që ndikojnë në uljen e shpenzimeve dhe duke u përqendruar në zhvillim të vazhdueshëm të ofertës dhe përmirësim koherent të shërbimit dhe njëkohësisht duke e rritur efikasitetin e strukturës organizative, përformancë biznesore ka qenë jo të kënaqshme, që do të paraqitet në mënyrë të detajuar në raport.

Tregu i transportit vendor të mallrave nuk ka qenë aspak i kënaqshëm, sepse me liberalizimin e tregut u nuk respektuan rregullat dhe standardet e operimit në transportin hekurudhor.

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala

III. 1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT 2022

Ngjarjet kryesore më rëndësi të veçantë që e kanë shoqëruar TRAINKOS-in gjatë vitit 2022 janë të paraqitura si në vijim:

1. Pjesëmarrja aktive në punëtoritë të organizuar nga Sekretariati për zbatimin e Traktatit për Transport, që reflekton në përmirësimin e aktiviteteve të kompanisë si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhorë dhe përshtatjen e reformave të domosdoshme për të qenë pjesë integruese e sistemit Evropian për transportin e udhëtareve dhe mallrave. Me avancimin e proceseve përfitojnë udhëtarët që shfrytëzojnë transportin me hekurudhë dhe bizneset për transportin e mallrave në dhe nga Republika e Kosovës;

2. Angazhim aktiv në fillimin e zbatimit të iniciativës së Sekretariati i Komunitetit të Transportit për Ballkanin Perëndimor (TCS) për vlerësimin e tregut hekurudhor në Ballkanin Perëndimor për sa i përket kapaciteteve, politikave, nivelit ekonomik dhe teknik të zhvillimit të segmenteve të transportit të mallrave dhe udhëtarëve. Në këtë iniciativë janë bërë përpjekje për sensibilizimin e faktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë për të i ndërmarrë masat e domosdoshme për aplikim në asociacione ndërkombëtare hekurudhore dhe **KODIN** unik për transport me hekurudhë. Përfitues janë të gjithë akterët pjesë përbërëse të sistemit hekurudhorë dhe shfrytëzuesit e këtyre shërbimeve;

3. Iniciativa të përbashkëta (Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i ndërmarrjes) për sensibilizimin e faktorit ndërkombëtarë (dashamir dhe përkrahës të shtetit tonë) që të mbështetin TRAINKOS-in. Kompania duke u lënë anash nga sektorët tjerë dhe kompania tjetër hekurudhore – INFRAKOS-i ka probleme të grumbulluara me flotën e mjeteve lëvizëse dhe për këtë ka filluar kontakte për të përfituar nga vullneti i mirë për mbështetej dhe ndihmë për të kaluar situatën aktuale. Përfitimi është direkt për kompaninë e më këtë krijon parakushte për plotësimin e kërkesave për transport duke pritur realizimin e planifikimeve shtetërore konform plotësimit të parakushteve për transport të sigurte dhe interoperabil;

4. Problemi për trajnim adekuat të stafit ekzekutiv ka imponuar angazhime vetanake për të realizuar këtë objektiv. Kjo është bërë me forcimin e zyrës për trajnime dhe mbajtja e trajnimeve profesionale për staf në mungesë të shkollave adekuate për këtë qëllim. Trajnimi dhe shkollimi i stafit krijon parakushte për plotësimin e reformave që priten të ndodhin në sektorin hekurudhorë e që kërkohet dije dhe vullnet. Zhvillimi i sektorit hekurudhorë modern në vend varet nga stafi i profesionalizuar që do të krijojmë;

5. Bashkëpunimi rajonal në fushën që mbulojmë është i domosdoshëm. Aktualisht veprohet në forma bashkëpunimi sipas qasjes politike të shteteve të rajonit dhe vullnetit të kompanive hekurudhore veç e veç, realizimi i iniciativës së filluar që nga muaji Shkurt 2016 për Marrëveshje gjithëpërfshirëse të procedurave kufitare me Republikën e Maqedonisë është diskutuar dhe priten rezultate. Përfitues janë shfrytëzuesit e transportit hekurudhorë, por edhe shteti i jonë që me zhvillimin më të lehtë hekurudhorë krijon parakushte për transport të sigurt dhe heqjen e mbingarkesave nga rrugët e porsandërtuara anekënd Republikës së Kosovës.

IV. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH. A.

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës sonë operative gjatë periudhës Dymbëdhjetë mujore (vjetore) nga 01 Janar 2022 deri më 31 Dhjetor 2022, duke prezantuar realizimin e detyrave në Departamentin e Transportit të Mallrave, krahasuar me planifikimin që është bërë për të njëjtën periudhë me planin e Biznesit të vitit 2022 si dhe duke krahasuar realizimin e vitit paraprak 2021 për të njëjtën periudhë raportuese. Natyrisht do të komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

IV. 1. DEPARTAMENTI I TRANSPORTI I MALLRAVE

Departamenti i Transportit të Mallrave gjatë kësaj kohe është munduar që të ketë një koordinim të mirë si brenda departamentit ashtu edhe me Departamentin e Transportit të Udhëtarëve, Administratës, Departamentin e Zhvillimit të Bizneseve si dhe Zyrës së Kontrollit ku nga vërejtjet dhe sugjerimet e tyre kemi bërë ndryshime që kanë qenë të mirëseardhura për kompaninë.

Në Departamentin e Transportit të Mallrave, i cili luan rol shumë të rëndësishëm për kompaninë, gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore (vjetore) respektivisht nga 01 Janar 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 kemi pasur këto rezultate:

Përshkrimi	Sasia e Transportuar Janar – Dhjetor 2022
Realizimi Neto Ton në 2021	538,012.46 Ton
Realizimi Neto Ton në 2022	22,340.07 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2022	313,941.00 Ton
Dallimi: Realizim 2022 – Realizim 2021	-515,672.39 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2022	-291,600.93 Ton
Dallimi: Realizim 2022 – Realizim 2021 (%)	4.15 %
Dallimi: Realizim 2022 – Planifikim 2022 (%)	7.12 %

Tabela 4.1.1


Siç mund të shihet nga tabela më lartë në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 95.85% më pak se sa në të njëjtën periudhë raportuese për vitin e kaluar dhe 92.88 më pak se sa sasia e planifikuar për këtë periudhë.

Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2022 ka qenë:

Përshkrimi	Numri i Transportuar i Kontejnerëve (Janar – Dhjetor 2022)
Kontejnerë të plotë – 2022	00.00 copë
Kontejnerë të plotë/zbrazët - 2022	00.00 copë

Tabela 4.1.2

Sasia e transportuar në Neto ton për vitin 2022



nga planifikimi i Planit të Biznesit i rishikuar për periudhën dymbedhjete mujore (vjetore) Janar – Dhjetor 2022.


Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Përshkrimi	Të hyrat për periudhën (Janar - Dhjetor 2022)
Realizim shitje të hyra 2021	1,092,660.76
Realizim shitje të hyra 2022	145,584.27
Planifikimi 2022	929,796.88
Realizim 2022 - Realizim 2021	-947,076.49
Realizim – Planifikim 2022	-784,212.61
Realizim 2022 - Realizim 2021 (%)	13.32%
Realizim – Planifikim 2022 (%)	15.66%

Tabela 4.1.3

Siç mund të shihet nga tabela më lartë Neto Ton të shprehura në të hyra me vlerë euro, kemi arritur 15.66% realizim nga planifikimi, për periudhën Janar – Dhjetor 2022 sipas Planit të Biznesit të rishikuar.

Të hyrat në periudhën vjetore 2022



Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet €
Shitjet nga transporti i mallrave	116,819.90 €
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	28,764.37 €
Total shitjet	145,584.27 €
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	407,969.88 €
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	74,210.85 €
Total shpenzimet	482,180.73 €
Fitimi/humbja operative	-336,596.46 €
Fitimi/humbja në %	-69.81%

Tabela 4.1.4


Siç mund të shihet nga tabela më lartë, Transporti i Mallrave ka pasur një humbje prej -336,596.46 euro ose për 69.81% shpenzime më të larta se të hyrat nga transporti.

Transporti i Mallrave në kostot indirekte ka marrë pjesë 5% të shpenzimeve në total të kompanisë, kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me tren/kilometra në komunikacion.

Mallrat e transportuara gjatë periudhës janar – dhjetor 2022

Gjatë vitit 2022 kemi transportuar mallra të ndryshme dhe nga 100 % i mallrave të transportuara kemi: Xehe e nikelit nga Importi 94.00%, Lokomotiva 3.00%, Mall i përzier 2.00%, Laminat 1.00%.

Figura 4.1.2



Revokimi i Trenave

Më poshtë do ti paraqesim revokimet e trenave të mallrave të ndarë sipas kategorive Import, Eksport dhe Vendorë.

Janar - Dhjetor 2022	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import-Export	252	0	44	4	2,671.20 €
Vendor	0	704	208	0	4,903.48 €
Total	252	704	252	4	7,574.68 €

Tabela 4.1.5

Nga tabela më lartë shihet që gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 në Import dhe Eksport janë revokuar në total treqind (300) trena. Katër (4) trena janë revokuar me 100% për shkak që trenat nuk kanë mundur të realizohen deri në ora 23:59 të datës së caktuar, dyzetekatër (44) trena janë revokuar me 20% për shkak se nuk ka pasur transport ose treni ka arritur vonë nga Maqedonia e Veriut, ndërsa dyqindepesëdhjetedy (252) trena janë revokuar me 0% për shkak të mbylljes 24 orëshe të segmentit hekurudhor Miradi – Hani i Elezit, për shkak të punimeve që janë duke u ekzekutuar në këtë segment hekurudhor.

Duhet theksuar se Menaxheri i Infrastrukturës për këto revokime nuk na ngarkon me shpenzime të revokimit.

Po ashtu nga tabela më lartë shihet që gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 në transport Vendor janë revokuar në total nëntëqindedymbëdhjetë (912) trena. Shtatëqindekatër (704) trena janë revokuar me 10% (treqindepesëdhjetepesë (355) të plotë dhe treqindedyzetenëntë (349) të zbrazët), dhe dyqindetetë (208) trena janë revokuar me 20% (njëqindenjë (101) të plotë dhe njëqindeshtatë (107) të zbrazët). Revokimi i këtyre trenave ka ndodhur për arsye se klienti NewCo Ferronikeli ka ndërprerë transportin nga muaji Tetor 2021.

IV. 2. DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Në fushën e sektorit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rezultate të kënaqshme krahasuar me vitin e kaluar.

Duhet të ceket se gjatë periudhës raportuese të gjithë trenat e relacionit të Hanit të Elezit nuk kanë qarkulluar prej për shkak të punimeve në rehabilitimin e linjës hekurudhore Leshak – Han i Elezit projekt i cili është në realizim e sipër. Gjatë periudhës raportuese kanë qarkulluar vetëm trenat e relacionit Prishtine - Pejë - Prishtinë.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën Janar - Dhjetor 2022 me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Në këtë tabelë shihet se kemi rritje të numrit të udhëtarëve në këtë vit krahasuar me numrin e udhëtarëve për vitin e kaluar.

Përshkrimi	Numri i Udhëtarëve
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2021	61 081
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2022	71 696
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2022	80 000
Dallimi: Realizim 2022 - 2021	10 615
Dallimi: Realizim - Planifikimi 2022	-8 304
Dallimi: 2022 - 2021 (%)	17.38
Dallimi: Realizim - Planifikimi 2022 (%)	-10.38

Tabela 4.2.1

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër më të madh të udhëtarëve krahasuar me vitin e kaluar apo **17.38 %** më shumë dhe **10.38 %** më pak kundrejt planifikimit. Vlen të theksohet se numri i udhëtarëve është edhe më i madh, por ne nuk kemi mekanizëm për përcaktimin e saktë të numrit të udhëtarëve të liruar nga pagesa dhe që frekuentojnë transportin hekurudhor.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar realizimi i transportit të udhëtarëve në vlera financiare:

Përshkrimi - Shitje e Biletave	Të hyrat
Realizim shitje të hyra 2021	51,205.25
Realizim shitje të hyra 2022	61,110.18
Planifikimi 2022	70,000.00
Dallimi: Realizim 2022 - Realizim 2021	9,904.93
Dallimi: Realizim - Planifikim 2022	-8,889.82
Dallimi: Realizim 2022 - Realizim 2021	19.34
Dallimi: Realizim - Planifikim 2022	-12.70

Tabela 4.2.2

Ndërsa reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, është **19.34 %** më shumë sesa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë dhe rreth **12.70 %** më pak sesa planifikimi i paraparë për këtë periudhë.




Figura 4.2.1

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve

Përshkrimi	Të hyrat (Janar - Dhjetor 2022)
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve – OSHP – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	1,062,671.82 €
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve – Ministria e Ekonomisë	610,275.00 €
Shitjet nga transporti i udhëtarëve	61,110.18 €
Të hyrat nga shërbimi i ID kartelave	472.89 €
Transport i organizuar i udhëtarëve	1,540.18 €
Total të hyrat	1,736,070.07 €
Shpenzimet direkte në TU	987,303.51 €
Shpenzimet indirekte në TU	1,410,006.21 €
Total shpenzimet	2,397,309.72 €
Fitimi / humbja operative	661,239.65 €

Tabela 4.2.3




Figura 4.2.2

Siç shihet nga tabela më lart, biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej – **27.58 %** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP, MZHE-ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

Vërejtje:

Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 95.00% nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.

IV. 3. ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE - MML

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen: mirëmbajtja e trenave motorik, lokomotivave transportuese, lokomotivave manovruese, vagonëve për transportin e udhëtareve, vagonëve për transportin e mallrave dhe punët tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

IV.3.1 Mirëmbajtja e trenave motorik

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e trenave motorik të realizuara ne vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2022	2021	Ndryshimi
1.	Servisime	0	2	-2
2.	Riparime	0	1	-1
3.	Kontrollime K1	0	1	-1
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	0	0	0
6.	Gdhendja e rrotave	0	0	0

Tabela 4.3.1

IV.3.2 Mirëmbajtja e Lokomotivave Transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

	Lloji i riparimit/mirembajtjes	2022	2021	Ndryshimi
1.	Servisime	257	462	-205
2.	Riparime	39	51	-12
3.	Kontrollime K1	23	32	-9
4.	Kontrollime K3	9	8	1
5.	Kontrollime K6	8	9	-1
6.	Gdhendje te rrotave	5	2	3

Tabela 4.3.2

IV.3.3 Mirëmbajtja e Lokomotivave Manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2022	2021	Ndryshimi
1.	Servisime	1	5	-4
2.	Riparime	9	9	0
3.	Kontrollime K1	5	8	-3
4.	Kontrollime K3	2	2	0
5.	Kontrollime K6	1	1	0

Tabela 4.3.3.1

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë vitit 2022 për secilin mjet tërheqës është dhënë në tabelën në vazhdim:

Mjeteti tërheqëse	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime	12	35	14		10	196	1		
Riparime	2	3	8	6	7	12	7		
Kontrollime mujore	3	4	3		1	8	5		
Kontrollime tre mujore		1	2		1	3	2		
Kontrollime gjashtë mujore	1	3	1		1	2			
Gdhendje të rrotave			1			1			

Tabela 4.3.3.2

S - Servisim,
R - Riparim,
K1 - Kontrollime njëmujor,
K3 - Kontrollime tremujor,
K6 - Kontrollime gjashtëmujor

IV.3.4 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimvev të komponenteve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve te udhetareve te realizuara ne vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

	Lloji i riparimit/mirembajtjes	2022	2021	Ndryshimi
1.	Kontrollime K1	88	96	-8
2.	Riparim në punëtori	51	55	-4
3.	Gdhendje të rrotave	21	8	13

Tabela 4.3.4

IV.3.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimvev të komponenteve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e vagoneve te mallrave te realizuara ne vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

	Lloji i riparimit/mirembajtjes	2022	2021	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	24	71	-47
2.	Riparim në punëtori	5	40	-35
3.	Gdhendje të rrotave	5	5	0

Tabela 4.3.5

IV.3.6 Riparimi i vagoneve të huaj

Rriparimi/mirembajtja e vagonëve të huaj	2022	2021
NewCo Feronikeli	**3,422.00 €**	**29,454.50 €**

Tabela 4.3.6

V. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

1. Gjendja financiare Janar – Dhjetor 2022
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2022)
3. Transaksionet e realizuara (Janar – Dhjetor 2022)
4. Bilanci i Gjendjes (Janar – Dhjetor 2022)

V. 1. Gjendja financiare

Për periudhën raportuese janar – dhjetor 2022, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

V. 1. 1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 116,819.00 për periudhën janar - dhjetor 2022. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2022, është 929,796.87€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 12.56% nga totali.
Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit janë 116,819.90€ dhe nga eksporti dhe transporti i brendshëm nuk janë realizuar të hyra në këtë periudhë.

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – dhjetor 2022, është realizuar në shumën prej 1,736,070.07 €. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 1,062,671.82 €, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 610,275.00 €. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 63,123.25 €, shprehur në përqindje më realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit 85.51%, krahasuar me planifikimet e vitit 2022 – 2,030,275.00 €.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - dhjetor 2022, kanë arritur shumën prej 11,048.22 €. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2022, e cila është 50,000.00 € arrin kuotën prej 22.10%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionin të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet dhe kontrata me kompaninë GCF.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, kanë arritur shumën prej 88,996.17 €. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – 27,132.45 € dhe të hyrat nga dëmtimi i vagonëve, kompensim i dëmit për vetura dhe kompensim i dëmit nga GCF në vlerë totale prej 44,147.57. Buxheti i planifikuar është 90,000.00 €, shprehur në përqindjen 98.88 %.

Të hyrat e realizuar gjatë kësaj periudhe janë jo të kënaqeshe, arsyeja e mos realizimit të planifikuar është si pasojë e rregullimit të Linjës së Dhjetë Hekurudhore nga HK Infrakos Sh.A, e cila ka ndikuar negativisht në realizimit e të hyrave për Transikos Sh.A, gjithashtu edhe ndërprerja e transportit vendor nga klienti ynë kryesor, NewCo Ferronikel, ka ndikuar në mos realizimin e të hyrave.

V. 1. 2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar–dhjetor 2022, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 721,742.13 € nga 944,500.00 € të planifikuara për vitin 2022 dhe arrijnë kuotën prej 76.42 %. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2022.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,674,604.22 €, dhe atë në paga dhe kontribute 1,674,194.22 € dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera në vlerë prej 410.00 €. Në total nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2022 – 1,934,000.00 €, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 86.59 %.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 169,990.47 €, kjo shumë është vetëm 140.49% nga shuma prej 121,000.00 € e parashikuar vitin 2022. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e më poshtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2022.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 59.04 %, konkretisht në shumën prej 57,857.65 €. Planifikimi për vitin 2022, i kësaj kategorie është 98,000.00 €. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2022.


Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Dhjetor 2022

	EMËRTIMI	Realizimi Janar-Dhjetor 2022	Buxheti 2022	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar-Dhjetor 2021
	A	B	C	D	E	B
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	116,819.90	929,796.87	(812,976.97)	12.56	1,092,660.76
2	TU – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktures	1,062,671.82	1,350,000.00	(287,328.18)	78.72	1,007,403.78
3	TU – Ministria e Ekonomisë	610,275.00	610,275.00	-	100.00	576,278.04
4	TU – Shitja e Biletave	63,123.25	70,000.00	(6,876.75)	90.18	51,406.11
5	Shërbimet tjera	11,048.22	50,000.00	(38,951.78)	22.10	40,443.68
6	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonave	17,716.15	70,000.00	(52,283.85)	25.31	18,126.80
7	Të hyrat tjera jo operative	71,280.02	20,000.00	51,280.02	356.40	23,880.33
I	TOTAL – TË HYRAT	1,952,934.36	3,100,071.87	(1,147,137.51)	63.00	2,810,199.50
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	434,844.02	465,000.00	(30,155.98)	93.51	562,969.76
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	22,704.12	25,500.00	(2,795.88)	89.04	24,984.39
3	Inventar dhe pajisje	2,314.57	3,000.00	(685.43)	77.15	1,177.78
4	Material harxhues	-	1,000.00	(1,000.00)	-	2,277.97
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	19,577.20	60,000.00	(40,422.80)	32.63	28,780.21
6	Qasja në binarë	195,446.18	320,000.00	(124,553.82)	61.08	367,126.58
7	Sigurimi i palëve të treta	3,734.00	3,000.00	734.00	124.47	1,688.14
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	2,621.94	42,000.00	(39,378.06)	6.24	123,699.67
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	26,336.50	20,000.00	6,336.50	131.68	22,629.86
10	Servisimi I arkave fiskale	-	5,000.00	(5,000.00)	-	-
11	Mosperputhje e stokut	(2,977.76)	-	(2,977.76)	-	-
12	Zbritjet e lejuara	17,141.36	-	17,141.36	-	1,406.21
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	721,742.13	944,500.00	(219,780.11)	76.42	1,136,740.57
	Fitimi (humbja) bruto	1,231,192.23	2,155,571.87	(924,379.64)	57.12	1,673,458.93
	TE ARDHURAT TJERA					
1	Te Ardhura të jashtëzakonshme	-	-	-	-	-
2	Të hyrat e shtyra (shpenzimet)	9,414.32	-	-	-	-
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	-	-	-		237,254.90
4	Te ardhura tjera	32,025.73	-	-	-	-
	TOTAL – Te ardhurat tjera	41,440.05	-	-	-	237,254.90
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,674,194.22	1,925,000.00	(250,805.78)	86.97	1,819,532.09
2	Sigurimi shendetsor, trajnime dhe Shpenzime tjera	410.00	9,000.00	(8,590.00)	4.56	2,026.00
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,674,604.22	1,934,000.00	(259,395.78)	86.59	1,821,558.09
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	9,503.29	10,000.00	(496.71)	95.03	17,633.45
2	Sigurimi fizik – total	-	-	-	-	-
3	Shërbimet tjera	-	-	-	-	-
4	Shpenzimet logjistike	26,352.20	22,000.00	4,352.20	119.78	13,620.82
5	Energjia elektrike dhe komunalite	5,079.89	7,500.00	(2,420.11)	67.73	5,288.91
6	Kontrollimet sistematike	1,900.00	2,000.00	(100.00)	95.00	2,800.00
7	Marketingu	6,363.54	11,000.00	(4,636.46)	57.85	5,101.40

8	**Udhëtimet zyrtare**	-	1,000.00	(1,000.00)	-	-
9	**Telefonat dhe Posta**	12,013.67	17,500.00	(5,486.33)	68.65	22,243.47
10	**Shërbimet bankare**	1,138.12	1,000.00	138.12	113.81	837.23
11	**Tatimet**	103,865.52	42,000.00	61,865.52	247.30	149,033.17
12	**Pajisje elektronike**	2,025.46	7,000.00	(4,974.54)	28.94	9,261.44
13	**Shpenzimet e interesit të kredisë**	1,748.78	-	1,748.78	-	-
	TOTAL - Shpenzimet operative	**169,990.47**	**121,000.00**	**48,990.47**	**140.49**	**225,819.89**
E	**Shpenzimet administrative**					
1	**Inventar dhe pajisje**	416.18	5,000.00	(4,583.82)	8.32	2,073.25
2	**Konsulenca dhe auditimi i jashtëm**	7,110.26	10,000.00	(2,889.74)	71.10	2,238.00
3	**Material i zyrës**	14,819.54	21,000.00	(6,180.46)	70.57	20,828.69
4	**Material sanitar**	2,314.69	7,000.00	(4,685.31)	33.07	3,061.67
5	**Qiraja për objektet**	13,283.41	15,000.00	(1,716.59)	88.56	15,056.64
6	**Reprezentacioni dhe bufeja**	2,945.30	6,000.00	(3,054.70)	49.09	3,444.49
7	**Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet**	6,684.65	5,000.00	1,684.65	133.69	15,800.81
8	**Shpenzimet logjistike**	8,213.62	19,000.00	(10,786.38)	43.23	18,508.49
9	**Kontigjente**	2,070.00	10,000.00	(7,930.00)	20.70	2,810.05
	TOTAL - shpenzimet administrative	**57,857.65**	**98,000.00**	**(40,142.35)**	**59.04**	**83,822.09**
	Provizionet e borgjeve të këqija	-	-	-	-	-
II	**TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)**	**2,624,194.47**	**3,097,500.00**	**(473,305.53)**	**84.72**	**3,267,940.64**
	Provizionimi I llogarive të arktueshme	**163,468.57**	-	**7,596.45**	-	-
III	**Fitimi (Humbja) para zhvlersimit**	**(793,288.63)**	**2,571.87**	**(639,988.38)**	**(24,784.17)**	**(220,486.24)**
	GRANTET	**490,459.47**	**570,000.00**	**(79,540.53)**	**86.05**	**956,300.18**
F	**Shpenzimet e zhvlerësimit**		-			
1	**Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve**	**490,459.47**	**570,000.00**	**(79,540.53)**	**86.05**	**956,300.18**
2	**Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë**	**54,955.59**	**30,000.00**	**24,955.59**	**183.19**	**55,034.79**
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	**545,415.06**	**600,000.00**	**(54,584.94)**	**90.90**	**1,011,334.97**
G	**Fitimi (humbja) nga veprimtaria**	**(848,244.22)**	**(27,428.13)**	**(664,943.97)**	**2,524.31**	**(275,521.03)**


Tabela 5.1

Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit për vitin 2022



Diagrami 5.1

Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2022



Diagrami 5.2

V. 2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës (31.12.2022)

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 31-12-2022
1.	PCB nr. 1114-004229-0001-59	297,866.53
2.	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3.	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	531.87
4.	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	68,610.15
5.	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	343,634.16
6.	GH-PCB nr. 1114004229040114	87.52
	TOTALI	**710,730.23**

Tabela 5.2

V.3. Transaksionet e realizuara (Janar – Dhjetor 2022)

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe llogaritë rrjedhëse për subvencione:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2022	281,727.46
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar– dhjetor 2022	1,273,008.93
Pagesat e kryera gjatë muajve janar– dhjetor 2022	1,256,869.86
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2022	297,866.53

Tabela 5.3

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2022	539.37
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2022	218,313.52
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2022	218,321.02
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2022	531.87

Tabela 5.4

Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MI dhe ME)	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2022	116,220.28
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2022	1,776,347.45
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2022	1,480,323.42
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2022	412,244.31

Tabela 5.5

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Janar - Dhjetor 2022			Pagesat Janar - Dhjetor 2022		
1.	Të hyrat nga MMPHI	1,166,072.45	1.	Shpenzimet e pagave	1,411,828.78
2.	Të hyrat nga Ministria e Ekonomisë	610,275.00	2.	Shpenzimet e derivateve	639,403.12
3.	Të hyrat nga Transporti i Mallrave	535,205.95	3.	Shpenzimet për investime kapitale	218,321.02
4.	Të hyrat nga kredia	364,963.00	4.	Shpenzimet për ATK	148,594.59
5.	Të hyra nga BK për Investime Kapitale	218,313.52	5.	Shpenzimet për Infrakos SH. A.	96,891.84
TOTALI		**2,894,829.92**	**TOTALI**		**2,515,039.35**

Tabela 5.6

V. 4. Bilanci i gjendjes (Janar – Dhjetor 2022)

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	**GJENDJA FILLESTARE 01/01/2022**	**GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.12.2022**
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	**2,818,330.52**	**2,440,607.65**
Mjetet Qarkulluese	**2,407,309.02**	**1,774,234.71**
Stoqet	432,761.70	426,548.91
Paraja	400,287.08	711,382.59
Llogarite e arketueshme	1,159,868.05	596,177.04
Kerkesa tjera te arketushme	393,806.95	30,386.55
Parapagimet	20,585.24	9,739.62
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	**5,225,639.54**	**4,214,842.36**
Detyrimet afatshkurta	**1,473,095.79**	**2,049,681.17**
Llogarite e pagueshme	863,568.07	886,770.10
Te pagueshme tjera - detyrime	1,117.61	1,351.49
Detyrime tatimore	608,410.11	796,596.58
Detyrimet e kredisë	0.00	364,963.00
Detyrimet afatgjata	**695,019.36**	**1,865,352.80**
Kapitali	**5,289,786.12**	**5,289,481.93**
Fitimi/Humbja e bartur	(1,974,973.71)	(4,141,429.31)
Fitim/ Humbja e vitit	(257,288.02)	(848,244.23)
Total detyrimet dhe kaptali	**5,225,639.54**	**4,214,842.36**

Tabela 5.7

VI. PROJEKTET KAPITALE TË HK - TRAINKOS SH. A.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të gjitha projektet/kontratat për vitin 2022, të financuara nga Buxheti Operativ i Trainkos Sh. A. dhe Buxhetin e Kosovës.

Nr.	Titulli i Aktivitetit të Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontratës	Koment
1.	Furnizimi dhe montimi i klimave për objektin e Tërheqjes	Janar	1,500.00€	1,260.00€	Përfunduar
2.	Furnizim me ventila sigurues hyrës dhe dalës për vinça hidraulik LUKAS	Janar	6,700.00€	5,660.00€	Përfunduar
3.	Furnizim me shëndrrues të tensionit	Shkurt	7,300.00€	4,510.80€	Përfunduar
4.	Riparimi i monitorit të lokomotivës tipi (GERSYS BC 3200)	Mars	5,000.00€	4,965.44€	Përfunduar
5.	Furnizimi me ujë në bidona	Mars	3,108.00€	2,671.99€	Përfunduar
6.	Furnizimi me senzor dhe modul për lokomotivën 010	Prill	9,855.00€	7,493.94€	Përfunduar
7.	Shërbimet e sigurimit të palëve të treta në transportin hekurudhor	Maj	4,000.00€	3,993.1 €	Përfunduar
8.	Furnizim me gjenerator të pulsit të rrotullimeve	Shtator	3,300.00€	3,242.98€	Përfunduar
9.	Furnizimi me papuçe frenuese për lokomotiva	Shtator	9,900.00€	7,817.50€	Përfunduar
10.	Furnizimi dhe instalimi i pompës, softwerit dhe pjesëve ndërlidhëse për shpërndarjen e naftës	Nëntor	19,000.00€	19,000.00€	Përfunduar
11.	Shërbimet e atestimit të vinçit 10t	Nëntor	2,500.00€	2,449.00€	Përfunduar
12.	Furnizimi me material higjiene për nevojat e Trainkos Sh. A.	Nëntor	5,900.00€	5,831.56€	Përfunduar
13.	Furnizimi dhe instalimi i pompave termike	Nëntor	120,114.80€	112,838.40€	Përfunduar
14.	Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit për menaxhimin e hyrje daljeve	Nëntor	7,500.00€	4,900.00€	Përfunduar
15.	Furnizimi dhe montimi i derës në MML	Dhjetor	1,900.00€	1,790.00€	Përfunduar
16.	Furnizimi me materiale reklamuese për fundvitit	Dhjetor	4,500.00€	2,790.00€	Përfunduar
17.	Furnizimi me bateri NiCd për lokomotiva 661	Dhjetor	30,000.00€	27,140.00€	Implementim
18.	Bateri startuse plumbi për lokomotiva	Dhjetor	16,000.00€	17,369.60€	Implementim
19.	Furnizimi me pjesë ndërrimi dhe riparime të ndryshme me vlera minimale	Janar - Dhjetor	12,000.00€	11,755.00€	Përfunduar

Tabela 6.1

VII. DEPARTAMENTI I ZHVILLIMI I BIZNESIT

VII.1. Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Departamenti i Zhvillimit të Biznesit gjatë vitit 2022 ka vazhduar me plotësimin e detyrave dhe obligimeve sipas planit të punës të përgatitur në fillim të vitit, plan i ndarë në periudha tremujore. Këto detyra janë përcaktuar me planifikimet strategjike të aprovuara në kompaninë tonë. Për shkak të pamundësisë së realizimit të "Strategjisë Afatmesme të Investimeve për TRAINKOS-in 2020 - 2024" të aprovuar në Nëntor 2019 me ngecjen e veprimeve nga përgjegjësit në sektor. Me këtë Strategji do të definoheshin politikat zhvillimore të TRAINKOS-it të koordinuara me Qeverinë dhe akterët tjerë të sektorit hekurudhorë Brenda dhe jashtë vendit. Njëkohësisht do të koordinohet edhe qasja tek IFN-të, mundësitë nga shtetet mike për mbështetje (donacione) dhe potenciali tjetër i mundshëm që do të na ofrohet në koordinim me ministritë përkatëse brenda Qeverisë së Kosovës. Por pritjet e njëjta si për vitin 2020, 2021 dhe tanimë gati në tërë vitin 2022 për zbatimin e reformave të shumëpritura në sektorin hekurudhorë nuk kanë ndodhur, presim që brenda vitit të finalizohet dhe aprovohet Strategjia e Transportit Multi - Modal. Poashtu, vazhdimi i zbatimit të projektit për Modernizimin e linjës së 10-të hekurudhore, masat e propozuara dhe iniciativat e ndërmarra nga BE-ja me funksionalizimin e Sekretariatit të Traktatit për Transport dhe angazhimet politike në arritjen e marrëveshjeve Serbi – Kosovë në transport nuk kanë avancuar për rrjedhat politike në vend dhe rajon.

Mund të potencohen problemet e TRAINKOS Sh. A. për zhvillimin e aktivitetit të vetë në ofrimin e shërbimeve gjatë vitit që po e lejmë pas. Kjo bartë pasojat e ndërprerjes së pjesshme dhe në disa raste (me paralajmërim apo pa paralajmërim) edhe e plotë e linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit, konkretisht me problemet në zbatimin e projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore. Në periudhën raportuese përveç tjerave është edhe problemi me tunelet dhe urat dhe paaftësia për vazhdim të punëve në një periudhë të pacaktuar! Problem në vete është edhe ndërprerja e transportit për nevojat e partnerit / kompanisë kryesore për biznesin tonë me vite (që nga Shtatori 2007) funksionale – New Co Ferronikeli. Nga takimi i fundit me menaxhmentin e ri të kësaj kompanie kemi kuptuar se tendenca për fillimin e transportit vendorë në Shkurt 2023 krijon atmosferë optimiste, dhe është përfshirë në planifikimet e kompanisë për vitin e ardhshëm. Sipas informatave të fundit kjo mund të ndodhë një muaj pas që krijon probleme shtesë në planifikimet për vitin 2023. Informatat nga partneri strategjik dhe zbatuesit e projektit për Modernizmi të Linjë së 10-të hekurudhore tregojnë rrjedhat pesimiste nëse kemi parasysh shtyerjes së afateve në finalizim të punëve dhe problemet me tunele dhe ura! Tendencat për zhvillim e modernizim të sektorit hekurudhorë me mbështetjen e BE-së dhe ndryshimet e shpeshta në faktorët politik bërës ndikojnë në stagnimin e nevojës urgjente në plotësimin, ndryshimin dhe avancimin e strategjive kombëtare për sektorin hekurudhorë dhe fillimin e zbatimit të tyre. TRAINKOS Sh. A. është pjesë e pandashme e proceseve në zhvillimin e sektorit hekurudhorë dhe kjo ndikon në krijimin e politikave zhvillimore në avancimin e mundësive për ofrimin e shërbimeve, por edhe avancimin e shërbimeve që ka mundësi ti funksionalizojë.

Konkretisht në stagnimin apo kthimin mbrapa të zhvillimeve të transporti hekurudhorë kanë ndikuar:

- Vazhdimi / stërzgjatja e zbatimit të projektit për Modernizimin e linjës së 10-të hekurudhore;
- Ndërprerja e transportit të kompanisë NewCo Ferronikeli që nga tetori 2021;
- Moszbatimi i masave të propozuara / kërkuara, si dhe iniciativat e ndërmarra nga BE-ja me funksionalizimin e Sekretariatit të Traktatit për Transport;
- Angazhimet politike në arritjen e marrëveshjeve Kosovë - serbi që për transport hekurudhorë do të thotë shumë për transportin hekurudhorë me Evropën ka Veriu;
- Amandamentimi / ndryshimi i Ligjit për Hekurudhat, Përpilimi dhe futja në funksion i Ligjit për Siguri dhe Interoperabilitet, legjislacioni primar dhe sekondar (zbatimi i Direktivave Evropiane për transport, Rregulloret adekuate të fushave të ndryshme për sektor (siguria, interoperabiliteti dhe transporti i mallrave të rrezikshëm) dhe rregulloret e Udhëzimet të secilit entitet hekurudhorë veç e veç, etj.) dhe
- Reformimi i funksionimit të TRAINKOS-it si operatorë strategjik në pronësi të Qeverisë së Kosovës në harmoni me reformat e aprovuara shtetërore dhe praktikave të mira ekzekutive.

Punët në realizimin e projektit në Modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore dhe planifikimet në Modernizimin e Linjës Lindje – Perëndim janë në vlug përkundër ndërprerjeve fillimisht sipas masave anti COVID e pastaj me probleme në realizimin e projektit sipas dinamikës. Parashikimet kanë qenë që sesioni Jug (Fushë Kosovë – Hani i Elezit) të përfundojnë brenda vitit 2021 (Dhjetorë). Fillimisht për shkak të vitit me Covid ky afat është shtyrë për 450 ditë, kurse fundi nuk po i dihet e kjo ndikon në planifikimet tona për vitin 2023 e tutje. Po të lëshohej Linja do të krijohen parakushte për shtrirjen e rrjetit hekurudhorë në pjesën kah kalon ky rrjetë (në Veri, Linjës së 10-të hekurudhore dhe linjat tjera ekzistuese hekurudhore) dhe lidhjen me portin e Selanikut, do të plotësojë parakushtet për Linjat e reja gjithashtu që janë paraparë me planifikimet strategjike afatgjata të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rëndësi të veçantë ka iniciativat bilaterale për vazhdimi / lidhjen e Linjës hekurudhore për Shqipëri, realizimi i kësaj linje Kosovës do të i mundëson edhe qasjen në Portet e Shqipërisë.

Kjo iniciativë e ngritur nga Ministri i MMPHI në Samitin e Beogradit të datës 13 Shtator, 2021 ka filluar të realizohet me zotimin e mjeteve për studimet e fizibilitetit dhe hapat e radhës për identifikimin e kompanisë që do e realizoj këtë projekt. Kjo do mundësojë që të avancojmë qarkullimin e mallrave me tren jo vetëm për Republikën e Kosovës por edhe shtetet tjera në kontinent nga Portet gjeografikisht strategjike të Shqipërisë. Paralajmërimet për investime në Portin e Durrësit dhe zgjatimi në portin e thatë në Prishtinë kërkon reformim në sektorin hekurudhë të Kosovës, për këtë kanë filluar iniciativa legale nga entitetet shtetërore dhe pretenduesit për të nxënë hapin në këtë biznes (Devolli Corporation p.sh.). TRAINKOS-i duhet të përshtatë veprimet strategjike me këto ndryshime të rëndësishme,

angazhime të menjëhershme paralel me zhvillimet në sektor duhet të bëhen. Konkretisht pjesëmarrje aktive në krijimin dhe përgatitjen për zbatim të legjislacionit për hekurudha, përgatitja e stafit dhe sigurimi i mjeteve lëvizëse adekuate për realizimin e kërkesave për transportin e udhëtarëve dhe mallrave.

Pjesëmarrja e TRAINKOS-it në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhorë përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme

Politikat e BE-së imponojnë reformat në transportin hekurudhorë përmes "Lëvizshmërisë së Qëndrueshme", ekzistojnë tri arsye themelore që justifikojnë marrjen e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe të zgjuar të Bashkimit Evropian dhe konceptin strategjik si bazë për Ballkanin Perëndimorë gjithashtu:

1. Ndotja është e madhe, prandaj arritjet për BE -në do të kërkojnë që edhe shtetet e Ballkanit Perëndimorë të punojnë drejt të njëjtave qëllime dhe objektiva për të siguruar që e gjithë Evropa të arrijë objektivat e saja për klimën;

2. Arritjet e përfituara dhe të përcaktuara në strategjinë e paraqitur nga Komisioni Evropian janë vendosur për vitet 2030, 2035 dhe 2050. Me një perspektivë të qartë të BE -së për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, prandaj mund të pritet që shumica ose të gjithë Partnerët Regjional të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian deri në këto data. Kjo nënkupton se ambiciet që janë vendosur nga BE për momentet tashmë merren parasysh nga Partnerët Regjional në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe

3. Të gjitha aktet legjislative që do të prezantohen ose rishikohen pas miratimit të Strategjisë së Komisionit Evropian do të bëhet pjesë integrale e Traktatit të Komunitetit të Transportit.

Gjatë periudhës raportuese pjesëmarrja e jonë ka qenë aktive në këto procese, koordinimi mes bartësit të zbatimit të obligimeve që dalin nga Traktati dhe Ligji i Kosovës për zbatimin e sajë – MMPHI ka mekanizma të dobët për veprime të suksesshme dhe nga kjo edhe raporti i Sekretariatit ka dalë me prezantimin e këtyre të metave!

Tregu i transportit hekurudhorë dhe problemet e TRAINKOS-it në realizimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve

Përkundër përsëritjes së vazhdueshme të kërkesës për pasurimin e flotës së mjeteve lëvizëse nuk kemi ndonjë përgjigje se a do të procedohet kërkesa e jonë e vazhdueshme për të i mundësuar TRAINKOS-it të i ketë në flotën e sajë mjetet lëvizëse të përshtatshme për plotësimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve. Problemet e mjeteve lëvizëse mbesin të hapura si për TU ashtu edhe për TM. Revizioni i vagonëve të udhëtarëve kërkon zgjidhje urgjente nëse e kemi parasysh periudhën e përfundimit të Marrëveshjes së OShP-së (Obligimi i Shërbimeve Publike) 2018 – 2022 dhe fundit e proceseve për nënshkrimin e Marrëveshjes së re pesë vjeçare. Këtu duhet të e kemi parasysh edhe skadimi i vlefshmërisë për futjen në operim të vagonëve të udhëtarëve pasi që revizioni pas vazhdimit dy herë ka gjashtë muaj ju kalon më 25.03.2023!? Flota e lokomotivave paraqet problem në vete për vëllimin minimal të transportit aktual e le më me fillimin e një fluksi të madh të

mundshëm transporti të mallrave dhe udhëtarëve sipas paralajmërimeve. Sigurimi i stafit të ri dhe të trajnuar paraqet një sfidë në veti për kompaninë që duhet të konsiderohet për veprim gjithashtu.

Transporti i xehes, lëndës finale dhe thëngjillit për "Ndërmarrja e Re Ferronikeli Complex Sh.P.K." nga eksporti, importi dhe transporti minierë – punëtori në Drenas është ndërprerë dhe ka paralajmërime se puna do të filloj në Mars 2023?

Rifillimi i transportit për Ferronikelin gjatë vitit 2022 ka ndodhë në muajin korrik (35 000 tonë import nga Selaniku). Është realizuar transporti i gjysmës së kësaj sasie, për shkak të mbylljes së linjë nga punimet pjesa tjetër sipas të gjitha rrethanave nuk do të mund të realizohet dhe kompania "Ferroniekeli Complex Sh.P.K" do të detyrohet ta bëjë këtë me potencial alternativ e jo me hekurudhë në territorin e Kosovës. Problem tjetër kryesorë për organizimin e transportit vendorë për këtë kompani është skadimi i revizionit të vagonëve në pronësinë e tyre!

Paralajmërimi i transportit të thëngjillit nga KEK-u dhe koncentratit / mbetjeve xeherore nga "Trepça" janë diskutuar me palët përgjegjëse të involvuara edhe gjatë kësaj periudhe. Ky potencial i mundshëm duke e përfshirë edhe kthimin e transportit të kontejnerëve dhe derivateve të naftë kërkon mobilizim të plotë dhe veprime të përgjegjshme nga kompetentët qeveritarë dhe të kompanisë. Gjatë muajit qershore në hapësirat e ME-së janë mbajt dy takime për krijimin e mundësive të transporti të thëngjillit nga KEK-u për Maqedoninë Veriore, problemi në riaftësimin e linjës / binarit industrial brenda KEK-ut pamundëson çfarëdo planifikimi të mundshëm brenda vitit 2022, mos veprimi në këtë drejtim dhe koha e nevojshme për këtë punë pamundëson planifikimet e duhura edhe për vitin 2023. Ky transport do të ndodhë gjithsesi dhe mos krijimi i mundësive do ishte i dëmshëm për biznesin e kompanive hekurudhore dhe rrugëve të porsandërtuara në Republikën e Kosovës! Kemi përcjell veprimet dhe nga krejt kjo kemi si rezultat një varg kamionësh që transportojnë thëngjill nga KEK-u, transport që është dashtë të transportohet me hekurudhë.

Gjatë periudhës raportuese me kërkesën e kompanisë Devolli Corporation janë mbajtur takime intensive në shfrytëzimin e mundësive për transportin e kontejnerëve për këtë kompani në dhe nga Kosova për nevojat e tyre dhe klientëve të tjerë potencial. Mundësia duhet të shqyrtohet me akterët tjerë relevant (INFRAKOS-i dhe Qeveria) me qëllim të realizimit të planeve për transport hekurudhorë me kontejnerë. Një parashikim i realizimit të punëve në përfundimin e punëve në sesionin Fushë Kosovë – Hani i Elezit për vitin 2023 nuk do komet dhe ngërthen komplikimet që do të pasojnë në realizimin e Planit të Biznesit të Trainkos-it për vitin 2023!

Zbatimi i Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 është në vitin e pestë (të fundit) të zbatimit. Vitit 2020 dhe ndarjet buxhetore për vitin 2021 tregojnë finalizimin e një procesi të gjatë për zbatimin e kësaj forme të kompensimit të humbjeve nga transporti i udhëtarëve, viti 2022 vazhdon me katër trena ditorë dhe buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e humbjeve nga Qeveria që do të krijohen gjatë vitit 2022. Problem afatshkurtër për këtë shërbim mbetet plotësimi i parakushteve të nevojshme për vazhdimin e OShP-së për vitet në vijim. Për këtë

janë marrë veprimet e domosdoshme për nënshkrimin e Marrëveshjes me MMPHI-në për publikimin e parakushteve për vazhdimin e këtij shërbimi për komunitetin dhe plotësimi i parakushteve nga pronari (ME-së) për furnizim me mjete lëvizëse adekuate dhe plotësimi i nevojave për staf të domosdoshëm teknik!

Plotësimi i kërkesave për transportin aktual dhe atyre të planifikuara në të ardhmen nga TRAINKOS-i me mjete lëvizëse kërkon kujdes të veçantë mirëmbajtjen e të njëjtave. Pra rritja e zhvillimit të kapaciteteve në transportin e mallrave dhe udhëtarëve kërkon përkushtim paralel edhe në mirëmbajtjen e tyre. Kjo ka ndikim direkt në plotësimin e kritereve standarde për shëndet dhe siguri, të përcaktuara nga Direktivat në fuqi që përcillen në zbatim nga asociacionet hekurudhore të Evropës dhe të kërkuara për zbatim prej ERA-s (Agjencinë Evropian për Hekurudha). Mos angazhimi i institucioneve përkatëse në krijimin e mundësive dhe veprimin në anëtarësimin e institucioneve dhe asociacioneve relevante ndërkombëtare dhe Kodin Hekurudhorë pamundëson të jemi pjesë përbërëse e botës së industrisë së transportit hekurudhorë! Reformat dhe zhvillimet në transportin hekurudhorë, modernizimi i linjave hekurudhore dhe krijimi i mundësive për blerjen e mjeteve lëvizëse të reja kërkon që TRAINKOS-i për vitet në vijim të plotësoj kriteret për mirëmbajtje të të njëjtave (me Licencë adekuate), konkretisht punëtori dhe kompletimi i stafit adekuat për këto detyrime.

VII.2. Koordinimi i proceseve me MMPHI, ARH-në dhe Institucionet tjera relevante

Periudha raportuese Janar – Dhjetor 2022 gjithashtu rezulton me angazhimin e vazhdueshëm në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ARH-në, Ministrinë e Ekonomisë (ME), ESK (Enti Statistikorë i Kosovës) dhe KHAIA.

- Me Komisionin e MMPHI-s për zbatimin e Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022, për vitin 2022 kanë vazhduar veprimet e njëjta sipas Marrëveshjes konkretisht faturimi në baza mujore dhe raportimi në kvartale;

- MMPHI-së ju janë përcjell statistikat e nevojshme për nevojat e Sekretariatit të Zbatimit të Traktatit për Transport;

- Së bashku me MMPHI dhe faktorët tjerë qeveritarë janë mbajte takime virtuale sipas planit të Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport;

- ARH, konkretisht Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, ka kërkuar dhe është informuar në periudha të rregullta për proceset e diskutimit të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 me MMPHI, zbatimi i marrëveshjeve tjera me INFRAKOS dhe MMPHI;

- Është kërkuar veprim nga MMPHI-ja në realizimin e përbashkët (duke e përfshirë edhe INFRAKOS-in) në plotësimin e planit të veprimit (TM1, TM2, TM3 dhe TM4)

të MMPHI-së në përgatitjen e drafteve të kërkesave për anëtarësim në asociacionet hekurudhore, në këtë drejtim nuk është ndërmarrë asnjë veprim deri tani;

- Me kërkesën e ARH-së është përgatitur dhe dërguar lista e makinistëve aktiv të dokumentuar me certifikatë mjekësore mbi moshën 55 vjeçare;

- Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të ARH-së duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta mujore;

- Me Departamentin e Sigurisë (ARH) është proceduar me kërkesën për tërheqjen e Autorizimit të mjeteve lëvizëse të cilat janë shitur si skrap;

- Jemi në vlugun e procedimit të kërkesës për fshirjen e mjeteve lëvizëse nga lista e NVR-së që janë shitur si skrap;

- Enti Statistikor i Kosovës është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta raportuese sipas kërkesës, këto statistika përcillen edhe në Eurostat;

- Për rastet e aksidenteve dhe incidenteve KHAIA-s ju është dërguar dokumentacioni i nevojshëm sipas kërkesës;

- Pjesëmarrje në takimin e Komitetit Teknik për hekurudha të mbajtur më 22.06.2022 dhe

- Pjesëmarrje aktive me përfaqësim zyrtarë nga TRAINKOS-i në përgatitjen e koncept dokumentit për ndryshimin / amandamentimin e Ligjit për Hekurudhat e Kosovës (Nr. 04/L – 063).

Tregu i transportit hekurudhorë dhe problemet e TRAINKOS-it në realizimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve

Përkundër përsëritjes së vazhdueshme të kërkesës për pasurimin e flotës së mjeteve lëvizëse nuk kemi ndonjë përgjigje se a do të procedohet kërkesa e jonë e vazhdueshme për të i mundësuar TRAINKOS-it të i ketë në flotën e sajë mjetet lëvizëse të përshtatshme për plotësimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve. Problemet e mjeteve lëvizëse mbesin të hapura si për TU ashtu edhe për TM. Revizioni i vagonëve të udhëtarëve kërkon zgjidhje urgjente nëse e kemi parasysh periudhën e përfundimit të Marrëveshjes së OShP-së (Obligimi i Shërbimeve Publike) 2018 – 2022 dhe fazën për përgatitjet e Marrëveshjes së re pesë vjeçare. Këtu duhet të e kemi parasysh edhe skadimi i vlefshmërisë për futjen në operim të vagonëve të udhëtarëve pasi që revizioni pas vazhdimit dy herë ka gjashtë muaj ju kalon më 25.03.2023!? Flota e lokomotivave paraqet problem në vete për

vëllimin minimal të transportit aktual e le më me fillimin e një fluksi të madh të mundshëm transporti të mallrave dhe udhëtarëve sipas paralajmërimeve. Sigurimi i stafit të ri teknik dhe të trajnuar paraqet një sfidë në veti për kompaninë që duhet të konsiderohet për veprim gjithashtu.

Transporti i xehes, lëndës finale dhe thëngjillit për "Ndërmarrja e Re Ferronikeli Complex Sh.P.K." nga eksporti, importi dhe transporti minierë – punëtori në Drenas është ndërprerë dhe ka paralajmërime se puna do të filloj në Mars 2023?

Rifillimi i transportit për Ferronikelin gjatë vitit 2022 ka ndodhë në muajin korrik (35 000 tonë import nga Selaniku). Është realizuar transporti i gjysmës së kësaj sasie, për shkak të mbylljes së linjë nga punimet, pjesa tjetër sipas të gjitha rrethanave nuk do të mund të realizohet dhe kompania "NewCo Ferronikeli" do të detyrohet ta bëjë këtë me potencial alternativ e jo me hekurudhë në territorin e Kosovës. Problem tjetër kryesorë për organizimin e transportit vendorë për këtë kompani është skadimi i revizionit të vagonëve në pronësinë e tyre!

Paralajmërimi i transportit të thëngjillit nga KEK-u dhe koncentratit / mbetjeve xeherore nga "Trepça" janë diskutuar me palët përgjegjëse të involvuara edhe gjatë kësaj periudhe. Ky potencial i mundshëm duke e përfshirë edhe kthimin e transportit të kontejnerëve dhe derivateve të naftë kërkon mobilizim të plotë dhe veprime të përgjegjshme nga kompetentët qeveritarë dhe të kompanisë. Gjatë muajit qershore në hapësirat e ME-së janë mbajt dy takime për krijimin e mundësive të transporti të thëngjillit nga KEK-u për Maqedoninë Veriore, problemi në riaftësimin e linjës / binarit industrial brenda KEK-ut pamundëson çfarëdo planifikimi të mundshëm brenda vitit 2022, mos veprimi në këtë drejtim dhe koha e nevojshme për këtë punë pamundëson planifikimet e duhura edhe për vitin 2023. Ky transport do të ndodhë gjithsesi dhe mos krijimi i mundësive do ishte i dëmshëm për biznesin e kompanive hekurudhore dhe rrugëve të porsandërtuara në Republikën e Kosovës!

Gjatë periudhës raportuese me kërkesën e kompanisë Devolli Corporation janë mbajtur takime intensive në shfrytëzimin e mundësive për transportin e kontejnerëve për këtë kompani në dhe nga Kosova për nevojat e tyre dhe klientëve të tjerë potencial. Mundësia duhet të shqyrtohet me akterët tjerë relevant (INFRAKOS-i dhe Qeveria) me qëllim të realizimit të planeve për transport hekurudhorë me kontejnerë.

Zbatimi i Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 është në vitin e pestë (të fundit) të zbatimit. Vitit 2020 dhe ndarjet buxhetore për vitin 2021 tregojnë finalizimin e një procesi të gjatë për zbatimin e kësaj forme të kompensimit të humbjeve nga transporti i udhëtarëve, viti 2022 vazhdon me katër trena ditorë dhe buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e humbjeve nga Qeveria që do të krijohen gjatë vitit 2022. Problem afatshkurtër për këtë shërbim mbetet plotësimi i parakushteve të nevojshme për vazhdimin e OShP-së për vitet në vijim. Për këtë kemi një situatë të pafavorshme nëse e kemi parasysh mos ndërmarrja e deritanishme të hapave të domosdoshme nga MMPHI-ja për publikimin e parakushteve për vazhdimin e këtij shërbimi për komunitetin dhe plotësimi i parakushteve nga pronari (ME-së) për furnizim me mjete lëvizëse adekuate dhe plotësimi i nevojave për staf të domosdoshëm teknik!

Plotësimi i kërkesave për transportin aktual dhe atyre të planifikuara në të ardhmen nga TRAINKOS-i me mjete lëvizëse kërkon kujdes të veçantë mirëmbajtjen e të njëjtave. Pra rritja e zhvillimit të kapaciteteve në transportin e mallrave dhe udhëtarëve kërkon përkushtim paralel edhe në mirëmbajtjen e tyre. Kjo ka ndikim direkt në plotësimin e kritereve standarde për shëndet dhe siguri, të përcaktuara nga Direktivat në fuqi që përcillen në zbatim nga asociacionet hekurudhore të Evropës dhe të kërkuara për zbatim prej ERA-s (Agjencinë Evropian për Hekurudha). Mos angazhimi i institucioneve përkatëse në krijimin e mundësive dhe veprimin në anëtarësimin e institucioneve dhe asociacioneve relevante ndërkombëtare pamundëson të jemi pjesë përbërëse e botës së industrisë së transportit hekurudhorë! Reformat dhe zhvillimet në transportin hekurudhorë, modernizimi i linjave hekurudhore dhe krijimi i mundësive për blerjen e mjeteve lëvizëse të reja kërkon që TRAINKOS-i për vitet në vijim të plotësoj kriteret për mirëmbajtje të të njëjtave (me Licencë adekuate), konkretisht punëtori dhe kompletimi i stafit adekuat për këto detyrime.

VII.3. Aktivitet e Marketingut

Sektori i Marketingut në aktivitetit për përpilimin e kontratave të transportit, përpunimin e analizës së buxhetit të të hyrave për klientë, kontakte dhe realizimin e vizita të vazhdueshme me klientët e rregullt, prezantimi i shërbimeve të Trainkos Sh. A. duke realizuar vizita drejt klientëve potencial, pranimin e kërkesave të transportit, procedimin e kërkesave drejt të gjithë partnerëve tanë vendor dhe ndërkombëtarë si dhe procedimin e ofertave drejt të gjithë klientëve.

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura Sektori i Marketingut ka kryer edhe aktivitete të tjera në fushën promovuese dhe menaxhon buxhetin e shpenzimeve të Sektorit të Marketingut për promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh. A. përmes kanaleve të ndryshme të marketingut.

Krahasuar me vitin paraprak sektori i marketingut në vitin 2022 ka pas në dispozicion 20,000.00€ buxhet të shpenzimeve për nevoja të promovimit të shërbimeve të Trainkos Sh.A. që nënkupton se ka shumën e njëjte të mjeteve të disponueshme se në vitin paraprak ku sipas të hyrave nga shitjet e parapara me rishikimin e planit të biznesit në nivel të kompanisë janë parapa të jenë rreth 929,351.60€ përgjatë vitit 2022 që nënkupton se shpenzimet e marketingut kanë marrë pjesë me vetëm 2.16 % në totalin e të hyrave të realizuara.

Buxheti i shpenzimeve të Marketingut përgjatë vitit 2022 kryesisht është shpenzuar për shtypjen e Orarit të Lëvizjes së Trenave për vitin 2022, si dhe urimin e festave zyrtare, pjesëmarrjen në Panair si dhe promovimi ne rrjetet sociale.

Klientët vendor të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh. A. për vitin 2022 është vetëm një klientë, si më poshtë:

Nr.	Emri i kompanisë	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësuesi	Vendi	Mallrat që transporton
1.	NewCo Ferronikeli	Iftach	Ben	Drenas	Xehe të nikelit, thëngjill.

Klientët/Partnerët të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh.A. për vitin 2022 janë gjithsej pesë partnerë. Duhet theksuar se pesë (5) partnerët që kanë nënshkruar kontratë transporti janë ndërkombëtarë.

Nr.	Emri i kompanisë	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësuesi	Vendi	Mallrat që transporton
1.	NAVICO SHIPPING DOO	Zlatko Crvenkoski	**JovanJovanovski**	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2.	CARGO LOGISTC DOO	Zoran Bakraceski	**MarjanVelevski**	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
3.	SHENKER DOEL	Zoran Lazorovski	**Tomislav Gjorceski**	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
4.	FERSPED AD	Ivan Petrovski	**Slavica Miseva**	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
5.	ARGO LOGISTIC INT	Viktor Tatabitovski	**Viktor Tatabitovski**	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet

Klientët/partnerët të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Hekurudhat e Kosovës – Trainkos – Sh. A. për vitin 2022 të njëjtit kanë pasur kontratë te nënshkruar edhe në vitin 2021.

Në bazë të dhënave që posedojmë dhe janë dërguar në analitikë, Sektori i Marketingut gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 është angazhuar maksimalisht për të realizuar aktivitetet e parapara në Planin Vjetor të Sektorit të Marketingut dhe po ashtu objektivat e përcaktuara nga Plani i Biznesit për vitin 2022.

Sektori i Marketingut ka realizuar kryesisht aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me përpilimin e kontratave të transportit, përpunimin e analizës së buxhetit të të hyrave për klientët e rregull, kemi mbajtur kontakte me klientë dhe me partnerë vendor dhe ndërkombëtarë, kemi pranuar kërkesa të transportit të cilat i kemi proceduar drejt të gjithë partnerëve tanë vendor dhe ndërkombëtarë si dhe procedimin e ofertave drejt të gjithë klientëve. Po ashtu jemi marrë edhe me përgatitjen e ofertave konkrete të udhëtimit me tren për Transport të Udhëtarëve, si dhe përgatitjen e ofertave speciale për udhëtime të veçanta.

Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes tonë në fushën promovuese ne nuk kemi qenë prezent në shumë kanale të marketingut për shkak të kostove shumë të larta dhe kemi shpenzuar në mënyrë sa me optimale të mundshme pasi që edhe kërkesa e DZhB-së ka qenë që të gjitha shpenzimet e Sektorit të Marketingut të minimizohen për shkak të gjendjes financiare jo të mirë në nivel të kompanisë.

VII.4. Raportimi i rregullt vjeor në Asociacionet tjera Hekurudhore dhe Sekretariatin për zbatimin e Traktatit për Transport

Viti 2022 ka rezultuar me veprime konkrete nga përgjegjësit e Sekretariatit për Zbatimin e Traktatit për Transport. Nga kontaktet, veprimet e ndodhura dhe pjesëmarrja në takime të organizuara kemi prezantuar gjendjen dhe nevojat e kompanisë.

VII.5. Shqyrtimi i mundësive për kryerjen e veprimtarisë – shpedicion për klientët e TRAINKOS-it

TRAINKOS Sh.A. me Certifikatë të regjistrimit të biznesit ka të drejtë që përveç transportit me hekurudhë të ofroj edhe shërbime tjera siç janë: Transport tjetër i rregullt tokësor i udhëtarëve, konstruktim dhe riparim të mjeteve lëvizëse hekurudhore, transport tokësor rrugor i udhëtarëve, transporti rrugor i mallrave, transporti detar dhe bregdetar, transport në rrugët e brendshme, ngarkim – shkarkim i peshave, magazinim i mallit, veprimtaritë tjera përcjellëse të transporti tokësor dhe veprimtari e agjencive të tjera të transportit. Zhvillimi i aktivitetit të shpedicionit që nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës (viti 2011) ka mbetur në fazën e përgatitjes së proceseve fillestare të zhvillimit të veprimtarisë dhe pret pëlqimin e stafit menaxhues dhe aprovimin nga Bordi i Drejtorëve për të filluar me këtë veprimtari. Duhet të e kemi parasysh se përfshirja e kësaj veprimtarie në shërbimet që ofron TRAINKOS-i do të mundësonte një qasje më të kompletuar në raport me klientët ekzistues dhe klientët e ri potencial në të ardhmen për transportin e mallrave dhe udhëtarëve.

VII.6. Sfidat kryesore gjatë vitit 2022 dhe veprimet për të ardhmen

Gjatë periudhës raportuese, si kompani vazhdojmë të ballafaqohemi me sfidat si në vijim:

1. Ballafaqimi në vazhdimësi me ndërprerje të linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit gjatë Modernizimit të këtij sesioni. Vonesat në realizimin e projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore" si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës dhe Porte detare;
2. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe nevoja për mjete lëvizëse adekaute për plotësimin e kërkesave për transportin e mallrave dhe udhëtarëve;
3. Restrikcionet e vendosura nga Maqedonia Veriore për transport të minimum 6 vagonëve që vijnë në drejtim të Kosovës;
4. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
5. Nevojitet ndryshimi / amandamentimi i Ligjit për Hekurudhat;
6. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
7. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
5. Mos zbatimi i bazës ligjore dhe mungesa e legjislacionit sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jo lojale;

6. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante dhe rreziku i regjistrimit të pretendentëve tjerë;
10. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetërorë në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
11. Mosha mesatare e lartë e personelit ekzekutiv, nevoja për staf të kualifikuar që mund të përcjell trendin e zhvillimit të reformave / zhvillimeve në sektor.

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, kompania është munduar në vazhdimësi që këto sfida / probleme t'i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje / mbështetje. Por ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të kompanisë.


Përkushtimi mbetet dhe do të insistojmë që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant në mënyrë që të marrim zgjidhjet e duhura, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.

Për këto sfida të precizuara më lart përgjegjësit në kompaninë Hekurudhat e Kosovës - TRAINKOS Sh. A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në realizimin e objektivave të parashtruara dhe tregojmë përkushtimin në angazhimet tona për të avancuar format e planifikimit në periudhat që na presin sipas ndryshimeve / planifikimeve shtetërore për transportin me hekurudhë.

VIII. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH. A.

Hekurudhat e Kosovës - Trainkos SH. A. brenda periudhës nëntëmujore janar – shtator 2022 në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime të cilat kanë reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së përgjithshme të të punësuarve. Në tabelën në vijim do të paraqesim gjendjen e të punësuarve në Kompani nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, duke filluar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, mosha mesatare, punëtorët me kontrata të afatizuara dhe të paafatizuara etj.

Skema organizative e HK-Trainkos Sh. A.



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK-Trainkos - SH. A. është si vijon:

Struktura e të punësuarëve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos -SH.A. më 1 Janar 2022 dhe më 31 Dhjetor 2022					
Totali i të punësuarve	**01.01.2022**		**31.12.2022**		
	226		**211**		
Vlerat	**Vlerat në numra**		**Vlerat në përqindje**		
Datat	**01.01.2022**	**31.12.2022**	**01.01.2022**	**31.12.2022**	
Mosha mesatare e punëtorëve	**46.73**	**46.96**	**%**	**%**	
Me marrëdhënie të rregullt pune	**226**	**211**	**%**	**%**	Gji Format e ni kontratave
Me kontratë të paafatizuar	**59**	**53**	**26.10%**	**25.11 %**	
Me kontratë të afatizuar	**167**	**158**	**73.89 %**	**74.88 %**	
Meshkuj	**199**	**183**	**88.10 %**	**86.72 %**	

Femra	**27**	**28**	**11.94 %**	**13.27 %**	
Serb	**2**	**2**	**0.88 %**	**0.94 %**	Nacionalite
Shqiptarë	**224**	**209**	**99.11 %**	**99.05 %**	
Me shkollim fillor	**10**	**5**	**4.42%**	**2.36 %**	Shkollimi
Shkollim Të mesëm	**127**	**122**	**56.19 %**	**57.81 %**	
Kualifikim profesional	**24**	**22**	**10.61 %**	**10.42 %**	
Me shkollim të lartë	**2**	**2**	**0.88 %**	**0.94 %**	
Me shkollim superior	**63**	**68**	**27.87 %**	**32.22 %**	
Zyrtarët e Lartë	**3**	**5**	**1.32 %**	**2.36 %**	Përshkrimi i Departamenteve
Departamenti i Transportit të Mallrave	**48**	**46**	**21.23 %**	**21.80 %**	
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	**60**	**56**	**26.54 %**	**26.54 %**	
Departamenti i Administratës	**49**	**46**	**21.68 %**	**21.80 %**	
Departamenti i Financave	**9**	**7**	**3.82 %**	**3.31 %**	
Departameti i Zhvillimit	**6**	**5**	**2.65 %**	**2.36 %**	
Departamenti i Prokurimit	**4**	**4**	**1.76 %**	**1.89%**	
Kabineti i KE-së	**3**	**2**	**1.32 %**	**0.94%**	Kabineti i KE-së dhe Zyret në kuadër të
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	**20**	**19**	**8.84 %**	**9.00 %**	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	**2**	**1**	**0.88 %**	**0.47 %**	
Zyra Ligjore	**3**	**3**	**1.32 %**	**1.42 %**	
Zyra e Mirëmbajtjes	**19**	**17**	**8.40 %**	**8.05 %**	

Tabela 8.1

Sqarim: Në tabelën e cekur më lartë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Sqarim i tabelës së lartcekur:

- Totali i të punësuarve me 01.01.2022 është 226 të punësuar.
- Totali i të punësuarve me 31.12.2022 është 211 të punësuar.

IX. ZYRA LIGJORE

IX.1. Kontestet gjygjësore

Gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2022, nga zyra ligjore e ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2022, pranë Gjykatave Themelore kanë qenë të caktuara 17 seanca gjyqësore për proceset në të cilat kemi qenë palë në procedurë qoftë në cilësinë e të paditurës apo të paditëses.

Gjatë këtij viti ndërmarrja në procedurë gjyqësore është përballur dhe ka zhvilluar veprime procedurale në njëmbëdhjet (11) konteste për kompensim dëmi, një (1) konteste për pagim borxhi, pesë (5) konteste të punës dhe gjashtëmbëdhjetë (16) konteste në procedurë përmbarimore. Pesë (5) lëndë kanë përfunduar në procedurë përmbarimore, një (1) lëndë përmbarimore kemi pranuar aktvendim të Gjykatës Themelore, katër (4) lëndë kemi pranuar aktgjykim të Gjykatës Themelore dhe procedura ka vazhduar në Gjykatën e Apelit, një (1) lëndë është kthyer në rigjykim me aktvendim të Gjykatës së Apelit, dy (2) lëndë kemi pranuar aktgjykim i Gjykatës së Apelit dhe procedura ka vazhduar në Gjykatën Supreme, dy (2) lëndë kanë përfunduar me aktgjykim të Gjykatës Supreme. Nga fitimi i kontestit në Gjykatë të Apelit dhe Gjykatë Supreme ndërmarrja nuk do të paguaj shumën e pretenduar nga paditësit prej 97,795.12, kurse i është kthyer ndërmarrjes shuma pre 31,161.32 euro, ndërsa ndërmarrja obligohet të paguaj shumën prej 12,455 euro duke përfshirë edhe kompensimin në emër të kontributit pensional dhe tatimit në burim-pagë me kamat sipas lartësisë që aplikohet në mjetet e deponuara në bankë për një vit, duke filluar nga data 11.12.2006 e gjerë në përmbushjen përfundimtare të detyrimit si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 1,067.
Shpenzime gjyqësore për pagesë e taksave dhe ato përmbarimore janë paguar në shumë prej 3,295.45 euro.

Gjatë kësaj periudhe kemi parashtruar një (1) padi, një (1) kundërpadi, një (1) propozim për përmbarim si dhe nga HK "Infrakos" Sh. A. kemi pranuar Akt përcjellës ku bëhet transferimi i lëndës P.nr.123/21 NT "Herolindi" me pronar Sadri Hajra, nga ''Infarkos" Sh. A, tek HK "Trainkos" Sh. A., sipas vendimit nr.716/2 I dt.31.08.2011 mbi ndarjen e lëndëve me rastin e ndarjes së Hekurudhave të Kosovës në dy kompani dhe kemi pranuar një padi.

Lidhur me marrëveshjen e nënshkruar me datë 24.05.2021 pranë Përmbaruesit Privat me kreditorin HK "Infrakos" Sh. A., për lëndën P.nr.17/2017, me borxh lëndor si në propozim për përmbarim prej 827,259.27 euro, i përmbaruar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr,2425/2020, për pagesën e borxhit të mbetur në vlerë prej 387.563.33 euro, i barazuar 06.05.2021 në mes të debitorit dhe kreditorit, i cili do të paguhet në 12 këste mujore për këtë vit janë paguar 3 këste në shumë prej 96,891.84 euro.

IX.2. Rreziqet nga kontestet gjygjësore për vitin 2023

Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" Sh. A. në vitin 2023, pritet të ballafaqohen me pesëdhjetë e katër **(54)** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të zhvillohen veprime procedurale dhe mund të përfundohen gjatë vitit 2023:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	//////////
1.	**Kontestet e marrëdhënies së punës**	**9**
2.	**Kontestet për kompensim të dëmit**	**24**
3.	**Kontestet për pagimin e borxhit**	**4**
4.	**Kontest nga Konflikti Administrativ**	**1**
5.	**Lëndë në procedurë përmbarimore**	**16**
	TOTALI	**54**

Tabela 9.1

X. PËRFUNDIM

TRAINKOS Sh. A. edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar të funksionoj sipas planifikimeve të prezantuar dhe aprovuara me Planin e Biznesit 2022. Pengesat për zhvillimin e biznesit vazhdojnë të ndikohen nga faktorë të ndryshëm. Rrethanat e krijuara dhe sfidat që përcjellin kompaninë që nga fillimi, por edhe paraqitja e pandemisë me virusin COVID 19 gjatë vitit 2021, por edhe paraqitja e krizës energjetike (fillimi i vitit 2022) kanë ndikuar mjaft shumë në operimin e rregullt në ofrimin e shërbimit në transportin e mallrave, transportin e udhëtarëve, mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse apo edhe fushëveprimet tjera të cilat janë vitale për një funksionim normal të kompanisë.

Ministritë përkatëse: MMPHI, ME dhe MFPT mbesin faktorë të jashtëm domethënës në zhvillimin e veprimtarisë dhe proceseve të ndodhura gjatë viteve pas procesit të ndarjes.

Politikat e aprovuara me Strategjitë përkatëse për sektorin hekurudhorë nuk janë zbatuar sipas planit të veprimit.

Me fillimin e zbatimit të projektit për modernizimin e sektorit Fushë Kosovë – Hani i Elezit rrit shpresat që Qeveria (aksionari 100% i TRAINKOS-it) të filloj të koordinojë veprimet edhe me zhvillimin e Operatorit hekurudhorë nëpërmes investimeve duke rritur kualitetin e punës dhe pasurimin e flotës me mjete lëvizëse.

TRAINKOS-i funksionon sipas strukturës organizative të aprovuar nga instancat përgjegjëse në bazë të gjendjes aktuale të transportit të mallrave dhe udhëtarëve por me zhvillimet që parashihen do të përkujdeset që të ketë staf profesional që mundëson krijimi i kushteve për siguri në punë dhe plotësimi i të gjitha kushteve tjera për transport të sigurt.

Procesi i avancimeve në sistemin hekurudhorë me planifikimet strategjike për kontinentin nga BE-ja, funksionalizimi i tërë Rrjeti Bazik Hekurudhorë të Evropës dhe kërkesat që vijnë nga nevoja për reformim të këtij sistemi në Evropën Jug Lindore kërkojnë përgatitje adekuate për kompaninë. Kjo nëse e kemi parasysh nevojën e planifikimeve të furnizimit me mjete lëvizëse adekuate sipas trendit të modernizimit të linjave hekurudhore dhe rritjes së vëllimit të transporti në dhe mbrenda vendit. Pastaj është dhe do të jetë sfiduese plotësimi i kritereve të Interoperabilitetit përmes TSI dhe plotësimi i kritereve / kërkesave që vijnë përmes Planit të Veprimit për Mekanizmin Stabilizim Asociim (PVMSA) dhe kërkesat tjera që TRAINKOS - i duhet të i plotësoj si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhorë të Republikës së Kosovës.

Veprim urgjent nevojitet kur kemi të bëjmë me Licencimin e punëtorive (në posedim të TRAINKOS-it), tani sipas Rregullores së lëshuar nga ARH-ja (Rregullorja Nr.01/2019 për verifikimin e entiteteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave, (datë 28.06.2019) që plotëson standardet e kërkuara nga ERA. Kjo vjen sipas kërkesës që vjen nga BE-ja përmes SEETO-s me mekanizmin e PVPE-së e që ka të bëjë me përpilimin dhe futjen në funksion të legjislacionit dytësorë për sektorin hekurudhorë, konkretisht licencimin për

mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore. Disa shtete në regjion kanë vepruar me shpejtësi dhe janë Licencuar, e për këtë duhet të fillohet me përcaktimin dhe zbatimin e detyrave që rrjedhin për këtë proces mbrenda kompanisë (stafi, punëtoritë, pajisjet dhe të tjera) në të gjitha punëtoritë e TRAINKOS-it.

Përkushtimi i përhershëm mbetet në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të ndërmarrjes në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve tona për klientët tanë.

Fushë Kosovë,

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala